



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Letërsi e Gjuhës B (3)

Ngarkesa: 4 kredite; 45 orë mësimore; 30 leksione / 15 seminare
Viti / Semestri : Viti III , semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti aftësohet të njohë proceset e zhvillimit të historisë së letërsisë italiane nga shek. XIX deri në shek. XX. Të lexojë vepra të disa autoreve të ndryshëm, të sugjeruar nga profesori apo dhe zgjedhje e tij e lirë. Studenti komenton tekste letrare dhe shkruan ese mbështetur mbi një mendim analitik. Njeh autorë e vepra si perfaqësues estetikash letrare dhe rrymash artistike. Ai analizon dhe formon një gjykim personal, të arësyeshëm dhe aktiv mbi momentet kyçe të letërsisë italiane në periudhën në studim.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të jetë i aftë të njohë lëvizjet artistike më të rëndësishme në letërsi, përfshirë autorët dhe veprat letrare përfaqësuese, përgjatë nga gjysma e dytë e shek. XIX deri në gjysmën e dytë të shek. XX si: Romantizmi, Verizmi, Parnasizmi, Pararafaleizmi, Simbolizmi, Dekadentizmi, Futurizmi, Dadaizmi, Ekspresionizmi, Surrealizmi, Krepuskolarizmi, Hermetizmi.
2. Të jetë i aftë të paraqesë një panoramë të letërsisë së kohës në studim në Itali dhe ndikimin që kjo letërsi ka nga ajo evropiane dhe botërore. Ai njeh shkrimtarët përfaqësues të rrymave letrare në studim: si: Alessandro Manzoni, Ippolito Nievo, Giovanni Verga etj, si dhe librat e tyre përfaqësues të cilët i lexon si literaturë e detyruar dhe prezantohet me literaturën shtesë. Studenti realizon kritikë personale letrare, memorizon poezi të autorëve të ndryshëm, përkthen poezi shkruan ese.
3. Të jetë i aftë të njoh vepra letrare si perfaqësuese estetikash letrare dhe rrymash artistike. Studenti njeh veprat e autorëve italianë të përkthyer në shqip. Studenti përgatit detyrën e kursit në formë eseje / projekti dhe e prezanton me gojë para grupit të studentëve.

Rezultate të pritshme:

1. Studenti fiton aftësinë për të zhvilluar kompetencën e arësytimit, argumentimit dhe sistemit të njohurive si nëpërmjet përzgjedhjes së materialeve ashtu edhe nëpërmjet diskutimeve dhe paraqitjes së eseve dhe projekteve përgjatë kursit.
2. Studenti fiton aftësinë për të ushtruar mendimin analitik, kritik, logjik dhe kreativ në interpretimin e fenomeneve të ndryshme letrare apo rrymave letrare.
3. Studenti zhvillon aftësinë për të komunikuar me gojë dhe me shkrim si dhe njeh terminologjinë bazë.
4. Studenti zhvillon kompetencën dixhitale: aftësinë për të kërkuar dhe administruar informacionin në internet. Studenti zhvillon kompetencën shoqërore dhe qytetare: nxitet puna në grup dhe sensibilizohet për temat sociale.